

Dr. A.S. Tony B. Watlington Sr., Ed.D.
Superintendent

8 Mars, 2023

Të Nderuar Prindër dhe Familje të Drejtorise Arsimore të Filadelfias,

Drejtoria Arsimore e Filadelfias është i përkushtuar të ofrojë një arsim të shkëlqyer për të gjithë nxënësit në çdo shkollë, kudo që ata jetojnë. Kurrikula që edukatorët japin mësim në klasa dhe burimet udhëzuese – mjetet që edukatorët përdorin për të zbatuar kurrikulën – janë komponentë të rëndësishëm në ofrimin e atij edukimi të shkëlqyer.

Në përputhje me Qëllimet dhe objektivat e Bordit të Arsimit, ne besojmë se studentët tanë meritojnë akses të barabartë në kurrikulë dhe burime mësimore me cilësi të lartë, të përafuar me standarde, që mbështesin suksesin e tyre akademik. Aktualisht, Drejtoria është në proces të kërkimit të burimeve të reja mësimore për të plotësuar kurrikulën tonë të përgjegjshme kulturalisht në fushat lëndore: PreK -12 Matematikë, PreK-12 Artet e Gjuhës Angleze (ELA), PreK-12 Shkenca, Klasat 3-12 Anglisht Zhvillimi i Gjuhës (ELD), dhe K-12 Burimet Suplementare të Arsimit Special.

Gjithashtu, ne besojmë se prindërit dhe familjet janë partnerë në edukimin e fëmijëve të tyre. Si i tillë, ju ftojme të merrni pjesë në procesin e zgjedhjes për burimet tona të reja mësimore. Ka një sërë mënyrash për t'u përfshirë.

- Ndani komentet tuaja mbi gjërat më të rëndësishme që Drejtoria duhet të marrë parasysh kur zgjedh burimet mësimore si pjesëmarrës aktiv në grupet e ardhshme, diskutimet mbi strategjinë dhe më shumë. Për të treguar interesin tuaj për të marrë pjesë aktive, ju lutemi plotësoni [këtë formë](#).
- Ndani komentet tuaja mbi gjërat më të rëndësishme që Drejtoria duhet të marrë parasysh kur zgjedh burimet mësimore duke plotësuar [këtë sondazh](#).
- Për të mësuar më shumë rreth vizionit tonë për kurrikulën dhe burimet mësimore, merrni pjesë në një nga sesionet javore informative të mbajtura çdo të Mërkurë nga ora 3:30 PM - 4:30 PM. Për t'u regjistruar klikoni [këtu](#).
- Takoni disa nga shitësit tanë të mundshëm të burimeve udhëzuese në Takimin dhe Përshëndetjen tonë të ardhshme. Veprimtaria do të mbahet në Qendrën tonë Edukative 440 N. Broad Street gjatë tre ditëve (ju ftojme të merrni pjesë në një ose të gjitha ditët):
 - o E Shtunë, 18 Mars 2023 (9:00 AM - 3:00 PM)
 - o E Diel, 19 Mars 2023 (9:00 AM - 1:00 PM)
 - o E Hënë, 20 Mars 2023 (9:00 AM - 7:00 PM)

Ne do të ndajmë mundësi shtesë për komentet tuaja në të ardhmen. Ndërkohë, faleminderit që gjetët kohë për të bashkëpunuar me ne në krijimin e një edukimi më të shkëlqyer dhe cilësor për fëmijët tanë. Pjesëmarrja juaj në këtë proces do të ndihmojë Drejtorinë Arsimore të Filadelfias të arrijë qëllimin tonë për t'u bërë drejtoria shkollore urbane me përmirësim më të shpejtë në vend.

Në partneritet,



Tony B. Watlington Sr., Ed.D.
Superintendent
Drejtoria Arsimore e Filadelfias